



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal
Dt.29.05.2013
01 Nr.06-793/4
D r a g a s h

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 12 të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe ndërrim të pronës së patundëshme të komunës-Ligji nr.04/L-144 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës") dhe nenit 57 të Statutit të Komunës-Dragash, pas shqyrtimit paraprak, në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit të dt.29.05.2013, mirahet ky:

V E N D I M

I. SHPALLET INTERESI PUBLIK:

- a) Në pjesën e parcelës kadastrale P-706040037-03281-0 (lista poseduese UL-70604037-00638) ZK Restelica e cila me Aktvendimin e Drejtorisë Pronëso- Juridike 04 nr.346-47/80 i është dhënë në shfrytëzim të përsershëm NBQ "Sharrprodhimi".
- b) Në pjesën e parces kadastrale P-70604037-01494-1 (lista poseduese UL-70604037-006638) ZK Restelica e cila me Aktvendimin e Drejtorisë Pronëso- Juridike 04 nr.463-27/85 të dt.11.02.1986 i është dhënë në shfrytëzim të përsershëm NBQ "Sharrprodhimi".

- II. Me këtë Vendim, po ashtu, përfshihen dhe objektet e ndërtuara në atë pjesë të parcelave të sipërpërmendura.

A r s y e t i m

Shpallja e Interesit Publik në pjesët e sipërpërmendura të parcelave dhe objekteve të fshatit Restelicë janë dhënë me qëllim të ndërtimit të Qendrës së Komuniteteve dhe Shtëpisë së Kulturës.

Me shiqimin e librave publike LKK-Dragash për ZK të Restelicës nuk ekzistojnë hapësira të tjera publike të cilat do të ishin adekuate për ndërtimin e ktyre dy objektvee.

Vendimi për shpalljen e Interesit Publik, sipas nenit 12 të Ligjit nr.04/L-144 i përcillet Qeverisë së Kosovës për vendosje të mëtejme për rikthimin e pjesëve të përmendura të parcelave dhe objekteve, në pronësi-Komunës.

Shjtojçë:

- Aktvendimi i Drejtorisë Pronëso- Juridike 04 nr.346-47/80 (kopja origjinale),
- Aktvendimi ... 04 nr.463-27/85 (kopje origjinale)

I dërgohet:

- Drejtoratit të Urbanizmit, Katastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit-Dragash,
- Qeverisë së Kosovës, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH

Kryesuesi
Shaban Shabani

